

VENDIM
Nr.233, datë 6.3.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“UNAZA KORÇË, LOTI II”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Korçë, loti II”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 817 (tetëqind e shtatëmbëdhjetë) m², tokë/truall, me vlerë 15 308 129 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e tetë mijë e njëqind e njëzet e nëntë) lekë, dhe për sipërfaqen 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², tokë/arë, me vlerë 68 322 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 15 376 451 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 487 000 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 15 376 451 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 5.3.2009 dhe të përfundojë më 30.5.2009.

7. Pronarët, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP” dhe “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHERBIMEVE MBESHTETESE
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NE SEGMENTIN RRUGOR “UNAZA KORÇE” loti II

							TOKE ARE			TOKE TRUALL		VLERA	
Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Zon Kad.	Nr.i Pas	SIP (m2)	Çmimi (L/m2)	VLERA(LEKE)	SIP(m2)	Çmimi(L/m2)	VLERA(LEKE)	TOTALE(LEKE)	Shenime
1	Gabriel		Heqimi	8561	9/3				246	18737	4609302	4609302	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Petrit		Heqimi										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Kleri		Heqimi										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
2	Irfan		Kamenica	8561	9/73	23	416.6	9581.8				9581.8	Konf. nga ZVRPP
3	Ilia		Pavlo	8561	9/16				34	18737	637058	637058	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Pavlo		Pavlo										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
4	Maqo		Çifligu	8561	9/109	32	416.6	13331.2				13331	Konf. nga ZVRPP
5	Mustafa		Beli	8561	9/108	35	416.6	14581				14581	Konf. nga ZVRPP
6	Koço		Lubonja	8561	9/107	27	416.6	11248.2				11248.2	Konf. nga ZVRPP
7	Koço		Feçani	8561	9/123				36	18737	674532	674532	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Pandush		Feçani										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Thanasaq		Feçani										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
8	Emilia		Gjergji+bashk.	8561	9/124				79	18737	1480223	1480223	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
9	Eleni		Mano+bashk.	8561	9/2				18	18737	337266	337266	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Zhorzheta		Mano										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Stela		Mano										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
10	Avdyl		Kalemi	8561	9/81	35	416.6	14581				14581	Plotësim dokumentacioni
11	Avdyl		Kalemi	8561	9/114				114	18737	2136018	2136018	Konf. nga ZVRPP
12	Valter		Mema+bashkp.	8561	9/36				96	18737	1798752	1798752	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
13	Bekdash	Adem	Pulaha +bashk.	8561	9/37				18	18737	337266		Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
14	Bubulina		Zallemi	8561	9/148				3	18737	56211	56211	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Jolanda		Çipi										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Frida		Molla										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
15	Jolanda		Çipi	8561	4/118				4	18737	74948	74948	Konf. nga ZVRPP
16	Bubulina		Zallemi	8561	4/496				6	18737	112422	112422	Konf. nga ZVRPP

17	Liljana		Kiçollari	8561	9/130	5	416.6	2083				2083	Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Donika		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Natasha		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Suzana		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Marjeta		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Gjergji		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
	Dhori		Kiçollari										Konf.ZVRPP(Bashkpronesi)
18	Liljana		Kiçollari	8561	9/129	7	416.6	2916.2				2916.2	Konf. nga ZVRPP
19	Pandeli	Vani	Façe	8561	3/901				45	18737	843165	843165	Konf. nga ZVRPP
20	Josif	Lefter	Kovaçi	8561	3/481				54	18737	1011798	1011798	Konf. nga ZVRPP
21	Artur	Pellumb	Cenolli	8561	3/889				64	18737	1199168	1199168	Konf. nga ZVRPP
TOTALI						164		68322.4	817		15308129	15376451.4	

